

VENDIM
Nr.691,datë 18.6.2009

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 3.2.2009, PËR ÇËSHTJEN NR.19206/05, “DAUTI KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të konventës europiane “Për të drejtat e njeriut”, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008, “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 3.2.2009, për çështjen nr.19206/05, “Dauti kundër Shqipërisë”, në shumën 6 000 (gjashtë mijë) euro, si dhe pagesën e tatimit për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 3.7.2009.

3. Detyrimi financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z. Ramiz Dauti dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së kësaj llogarie.

5. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, z.Ramiz Dauti, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

6. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha